

Indeksi i Çmimeve të Prodhimit

Tremujori I, 2016

Tiranë, më 06 Qershor: Në tremujorin e parë të vitit 2016, Indeksi i Çmimeve të Prodhimit arriti 97,4 % kundrejt vitit 2010. (Viti 2010 = 100).

Në tremujorin e parë 2016 ndryshimi vjetor i Indeksit të Çmimeve të Prodhimit është -4,1%. Uljen më të lartë e kanë shënuar çmimet e prodhimit në seksionin “Industri nxjerrëse” me 12,6 %. Brenda kësaj industrie vihet re ulja e çmimeve të prodhimit të produkteve në aktivitetin “Nxjerrja e naftës bruto dhe gazit natyror” me 18,3 %.

Referuar të njëjtës periudhë krahasimi, Indeksi i Çmimeve të Prodhimit në aktivitetet e Industrisë përpunuese kanë shënuar ulje me 1,6 %. Vihet re ulje e çmimeve të prodhimit në metalurgji me 8,8 %, përpunimin e tekstileve me 5,1 %, prodhimi i letrës dhe produkteve prej letre me 3,8 %. Ndërsa çmimet e prodhimit në përpunimin e produkteve ushqimore kanë shënuar rritje me 0,8 % dhe çmimet e prodhimit të konfeksionimit të veshjeve kanë shënuar rritje me 1,2 %.

Krahasuar me tremujorin e parë të vitit 2015, çmimet e prodhimit të produkteve vendase shënuan ulje me 0,5 %. Vihet re ulja e çmimeve të prodhimit të produkteve në seksionet; “Industri nxjerrëse” me 1,4 %, “Industri përpunuese” me 0,5 %.

Çmimet e prodhimit të produkteve për eksport kanë shënuar ulje me 8,3 % krahasuar më të njëjtën periudhë të vitit të mëparshëm. Ulje të konsiderueshme kanë pësuar çmimet e prodhimit për eksport në aktivitetin “Nxjerrja e naftës bruto dhe gazit natyror” me 20,7 %.


Në tremujorin e parë 2016 ndryshimi tremujor i indeksit është -2,2 %. Çmimet e Prodhimit në seksionin “Industri Nxjerrëse” shënuan ulje me 6,4 % krahasuar me tremujorin e katërt 2015. Uljen më të lartë e shënuan çmimet e prodhimit në aktivitetin “Nxjerrja e naftës bruto dhe gazit natyror” me 9,1 %.

Indeksi i Çmimeve të Prodhimit të seksionit “Industria përpunuese” ka shënuar ulje 1,4 % krahasuar me tremujorin e mëparshëm. Brenda kësaj industrie vihen re ulje të çmimeve të produkteve në aktivitetet si: përpunimi i tekstileve me 3,5 %, metalurgjia e metaleve me 8,1 %. Çmimet e prodhimit në aktivitetet e përpunimit të produkteve ushqimore kanë shënuar rritje me 0,3 %, konfeksionimi i veshjeve me 0,4 %.

Indeksi i Çmimeve të Prodhimit për produktet vendase arriti 99,0 % duke shënuar një rritje me 0,6 % krahasuar me tremujorin e katërt 2015. Vlen të përmendet rritja e çmimeve të prodhimit të produkteve në seksionin "Industri Nxjerrëse" me 4,7 %. Çmimet e prodhimit për produktet vendase në seksionin "Industri përpunuese" shënuan ulje me 0,3 %.

Indeksi i Çmimeve të Eksportit arriti 95,9 % duke shënuar një ulje me 6,1 % krahasuar me tremujorin e mëparshëm. Çmimet e prodhimit të produkteve në seksionet: "Industri nxjerrëse" dhe "Industri përpunuese" kanë shënuar ulje përkatësisht 12,7 % dhe 2,5 %.

Fig. 1 Indeksi i Çmimeve të Prodhimit sipas muajve , Janar 2015 – Mars 2016



Tab. 1 Indeksi i Çmimeve të Prodhimit

2010=100

%

NVE	Përshkrimi	Peshat	01 - 16	02 - 16	03 - 16	I - 16
	Gjithsej	100,0	96,7	97,8	97,7	97,4
B	Industri Nxjerrëse	21,4	78,0	83,4	85,5	82,3
06	Nxjerrja e naftës bruto dhe gazit natyror	14,1	71,4	79,3	82,3	77,7
07	Nxjerrja e mineraleve metalore	5,1	99,8	100,3	100,4	100,2
08	Nxjerrja e mineraleve të tjera nga minierat apo karrierat	2,2	103,3	103,5	103,8	103,5
C	Industria Përpunuese	50,0	103,9	103,4	102,2	103,2
10	Përpunimi i produkteve ushqimore	7,2	107,3	107,8	107,6	107,6
11	Prodhimi i pijeve	2,7	105,4	106,7	106,2	106,1
12	Prodhimi i produkteve të duhanit	0,2	92,6	92,6	92,6	92,6
13	Përpunimi i tekstileve	0,4	101,2	101,2	101,2	101,2
14	Konfeksionimi i veshjeve	4,2	107,9	108,0	108,2	108,0
15	Prodhimi i lëkurës dhe produkteve prej lëkure	5,1	109,0	108,9	108,9	108,9
16	Prodhimi i drurit dhe produkteve prej druri dhe dushku, përveç mobiljeve; prodhimin e artikulave prej kashte dhe xunkthi	1,0	111,0	110,9	110,9	110,9
17	Prodhimi i letërës dhe produkteve prej letre	0,8	102,5	102,0	102,0	102,1
18	Shtypshkrimi dhe rigrupimi i mediave të regjistruara	1,4	93,8	93,0	93,8	93,6
19	Përpunimi i koksit dhe rafineria e nënprodukteve të naftës	1,1	107,3	107,3	107,4	107,4
20	Prodhimi i kimikateve dhe produkteve kimike	1,1	102,4	102,4	102,4	102,4
21	Përpunimi i produkteve dhe preparateve farmaceutikë	0,3	96,8	96,8	96,8	96,8
22	Prodhimi i produkteve të kauçikut dhe plastikës	1,2	115,6	115,6	115,6	115,6
23	Prodhimi i produkteve minerale jo metalike	8,7	99,0	99,1	98,8	99,0
24	Metalurgjia	7,2	91,7	87,6	81,0	86,8
25	Prodhimi i produkteve metalikë të fabrikuar, përveç makinerive dhe pajisjeve	4,6	106,7	106,3	105,9	106,3
26	Prodhimi i produkteve optikë, elektronikë, kompjuterikë	0,1	110,9	110,9	110,9	110,9
27	Prodhimi i pajisjeve elektrike	0,3	110,3	110,3	110,3	110,3
28	Prodhimi i makinerive dhe pajisjeve p,k,t	0,2	117,9	117,9	117,9	117,9
29	Prodhimi i mjeteve të transportit, rimorkiove dhe gjysëmrimorkiove	0,0	102,0	102,0	102,0	102,0
31	Prodhimi i mobiljeve	2,0	115,7	115,6	115,8	115,7
32	Industri të tjera p,k,t	0,2	102,0	102,0	102,0	102,0
33	Riparimi dhe instalimi i makinerive dhe pajisjeve	0,0	109,4	109,4	109,4	109,4
D	Energjia elektrike, gaz, avull dhe ajër i kondicionuar	24,8	99,1	99,1	99,1	99,1
35	Energjia elektrike, gaz, avull dhe ajër i kondicionuar	24,8	99,1	99,1	99,1	99,1
E	Fumizimi me ujë, aktivitete të trajtimit dhe menaxhimit të mbeturinave, mbetjeve	3,8	100,6	100,6	99,8	100,3
36	Fumizimi me ujë, aktivitete të trajtimit dhe menaxhimit të mbeturinave, mbetjeve	1,8	113,2	113,2	113,2	113,2
37	Shërbime të trajtimit të kanalizimeve	0,2	101,5	101,5	101,5	101,5
38	Aktivitetet e grumbullimit, trajtimit dhe asgjësimit të mbetjeve; rikuperimi i materialeve	1,8	82,1	82,0	80,6	81,6

Tab.2 Ndryshimet tremujore dhe vjetore të Indeksit të Çmimeve të Prodhimit

			%	
NVE	Përshkrimi	Peshat	I-16 / IV - 15	I-16 / I-15
	Gjithsej	100,0	-2,2	-4,1
B	Industri Nxjerrëse	21,4	-6,4	-12,6
06	Nxjerrja e naftës bruto dhe gazit natyror	14,1	-9,1	-18,3
07	Nxjerrja e mineraleve metalore	5,1	-2,1	-0,2
08	Nxjerrja e mineraleve të tjera nga minierat apo karrierat	2,2	1,0	1,7
C	Industria Përpunuese	49,9	-1,4	-1,6
10	Përpunimi i produkteve ushqimore	7,2	0,3	0,8
11	Prodhimi i pijeve	2,7	-1,4	-1,3
12	Prodhimi i produkteve të duhanit	0,2	0,0	0,0
13	Përpunimi i tekstileve	0,4	-3,5	-5,1
14	Konfeksionimi i veshjeve	4,2	0,4	1,2
15	Prodhimi i lëkurës dhe produkteve prej lëkure	5,1	-1,3	0,3
16	Prodhimi i drurit dhe produkteve prej druri dhe dushku, përveç mobiljeve; prodhimin e artikujve prej kashte dhe xunkthi	1,0	-0,7	1,2
17	Prodhimi i letrës dhe produkteve prej letrë	0,8	0,0	-3,8
18	Shtypshkrimi dhe rigrupimi i mediave të regjistruara	1,4	0,1	-0,5
19	Përpunimi i koksit dhe rafineria e nënprodukteve të naftës	1,1	-0,4	-1,1
20	Prodhimi i kimikateve dhe produkteve kimike	1,1	-0,4	2,2
21	Përpunimi i produkteve dhe preparateve farmaceutikë	0,3	-0,6	-0,6
22	Prodhimi i produkteve të kauçukut dhe plastikës	1,2	-0,1	-0,6
23	Prodhimi i produkteve minerale jo metalike	8,7	0,1	-2,4
24	Metalurgjia	7,2	-8,1	-8,8
25	Prodhimi i produkteve metalikë të fabrikuar, përveç makinerive dhe pajisjeve	4,6	-1,3	0,3
26	Prodhimi i produkteve optikë, elektronikë, kompjuterikë	0,0	0,1	5,8
27	Prodhimi i paisjeve elektrike	0,3	-0,1	0,2
28	Prodhimi i makinerive dhe paisjeve p,k,t	0,2	2,2	7,5
29	Prodhimi i mjeteve të transportit, rimorkiove dhe gjysërimorkiove	0,0	0,0	-1,6
31	Prodhimi i mobiljeve	2,0	1,6	-0,8
32	Industri të tjera p,k,t	0,2	-0,7	-3,1
33	Riparimi dhe instalimi i makinerive dhe pajisjeve	0,0	0,0	1,6
D	Energjia elektrike, gaz, avull dhe ajër i kondicionuar	24,9	-0,3	-0,3
35	Energjia elektrike, gaz, avull dhe ajër i kondicionuar	24,9	-0,3	-0,3
E	Furnizimi me ujë, aktivitete të trajtimit dhe menaxhimit të mbeturinave, mbetjeve	3,8	-1,0	-2,1
36	Furnizimi me ujë, aktivitete të trajtimit dhe menaxhimit të mbeturinave, mbetjeve	1,8	0,3	0,9
37	Shërbime të trajtimit të kanalizimeve	0,2	0,0	0,0
38	Aktivitetet e grumbullimit, trajtimit dhe asgjësimit të mbetjeve; rikuperimi i materialeve	1,8	-2,8	-5,9

Tab.3 Indeksi i Çmimeve të Prodhimit të produkteve për tregun vendas

2010 = 100

%

NVE	Përshkrimi	Peshat	01 - 16	02 - 16	03 - 16	I - 16	I-16 / IV - 15
	Gjithsej	100,0	98,7	98,9	99,4	99,0	0,6
B	Industri Nxjerrëse	10,3	91,6	93,5	98,4	94,5	4,7
06	Nxjerrja e naftës bruto dhe gazit natyror	3,7	85,2	90,3	103,9	93,1	2,6
07	Nxjerrja e mineraleve metalore	3,2	113,2	113,2	113,2	113,2	1,1
08	Nxjerrja e mineraleve të tjera nga minierat apo karrierat	3,3	103,7	103,9	104,2	103,9	1,2
C	Industria Përpunuese	42,6	102,7	102,7	102,6	102,7	-0,3
10	Përpunimi i produkteve ushqimore	8,7	108,3	108,6	108,6	108,5	0,5
11	Prodhimi i pijeve	4,4	105,0	106,4	105,9	105,8	-1,5
12	Prodhimi i produkteve të duhanit	0,3	92,6	92,6	92,6	92,6	0,0
13	Përpunimi i tekstileve	0,1	87,3	87,2	87,2	87,2	0,8
14	Konfeksionimi i veshjeve	1,3	107,0	106,9	106,9	106,9	-1,0
15	Prodhimi i lëkurës dhe produkteve prej lëkure	1,7	114,6	114,4	114,4	114,4	-0,2
16	Prodhimi i drurit dhe produkteve prej druri dhe dushku, përveç mobiljeve; prodhimin e artikujve prej kashte dhe xunkthi	1,0	106,4	106,4	106,4	106,4	-1,1
17	Prodhimi i letrës dhe produkteve prej letre	0,1	103,0	96,9	96,9	99,0	0,5
18	Shtypshkrimi dhe rigrupimi i mediave të regjistruara	2,3	93,8	93,0	93,8	93,6	0,1
19	Përpunimi i koksit dhe rafineria e nënprodukteve të naftës	0,4	96,7	96,7	97,3	96,9	-3,8
20	Prodhimi i kimikateve dhe produkteve kimike	1,1	96,0	96,0	96,0	96,0	-0,6
21	Përpunimi i produkteve dhe preparateve farmaceutikë	0,5	96,7	96,7	96,7	96,7	-0,7
22	Prodhimi i produkteve të kauçikut dhe plastikës	1,4	114,1	114,1	114,1	114,1	-0,2
23	Prodhimi i produkteve minerale jo metalike	10,7	88,9	88,9	88,8	88,9	0,1
24	Metalurgjia	1,3	89,4	89,4	89,4	89,4	0,0
25	Prodhimi i produkteve metalikë të fabrikuar, përveç makinerive dhe pajisjeve	4,4	99,0	98,5	97,7	98,4	-2,4
27	Prodhimi i pajisjeve elektrike	0,1	110,7	110,7	110,7	110,7	0,0
28	Prodhimi i makinerive dhe pajisjeve p,k,t	0,1	113,4	113,4	113,4	113,4	4,4
29	Prodhimi i mjeteve të transportit, rimorkiove dhe gjysmë rimorkiove	0,1	100,0	100,0	100,0	100,0	0,0
31	Prodhimi i mobiljeve	2,6	120,4	120,3	120,3	120,3	1,6
32	Industri të tjera p,k,t	0,1	108,2	108,2	108,2	108,2	-3,6
33	Riparimi dhe instalimi i makinerive dhe pajisjeve	0,1	118,2	118,2	118,2	118,2	0,0
D	Energjia elektrike, gaz, avull dhe ajër i kondicionuar	42,3	99,1	99,1	99,1	99,1	-0,3
35	Energjia elektrike, gazi, avulli dhe ajri kondicionuar	42,3	99,1	99,1	99,1	99,1	-0,3
E	Furnizimi me ujë, aktivitete të trajtimit dhe menaxhimit të mbeturinave, mbetjeve	4,8	105,9	105,9	105,9	105,9	0,2
36	Furnizimi me ujë, aktivitete të trajtimit dhe menaxhimit të mbeturinave, mbetjeve	3,1	113,2	113,2	113,2	113,2	0,3
37	Shërbime të trajtimit të kanalizimeve	0,3	101,5	101,5	101,5	101,5	0,0
38	Aktivitetet e grumbullimit, trajtimit dhe asgjësimit të mbetjeve; rikuperimi i materialeve	1,4	79,5	79,5	79,5	79,5	0,1

Tab. 4 Indeksi i Çmimeve të Prodhimit të produkteve për eksport

2010 = 100

%

NVE	Përshkrimi	Peshat	10 - 15	11 - 15	12 - 15	IV - 15	IV-15 / III - 15
	Gjithsej	100,0	94,6	96,9	96,1	95,9	-6,1
B	Industri Nxjerrëse	37,0	75,3	82,2	83,3	80,2	-12,7
06	Nxjerrja e naftës bruto dhe gazit natyror	28,8	70,2	78,6	80,0	76,3	-12,2
07	Nxjerrja e mineraleve metalore	7,6	92,0	92,7	92,9	92,6	-2,6
08	Nxjerrja e mineraleve të tjera nga minierat apo karrierat	0,6	103,5	103,5	103,5	103,5	-0,4
C	Industria Përpunuese	60,5	105,3	104,1	101,9	103,8	-2,5
10	Përpunimi i produkteve ushqimore	5,2	104,7	105,9	105,3	105,3	-0,1
11	Prodhimi i pijeve	0,3	99,1	99,1	99,1	99,1	-0,1
12	Prodhimi i produkteve të duhanit	0,1	106,7	106,7	106,7	106,7	4,4
13	Përpunimi i tekstileve	0,7	109,4	109,4	109,4	109,4	-4,4
14	Konfeksionimi i veshjeve	8,3	108,1	108,3	108,5	108,3	0,8
15	Prodhimi i lëkurës dhe produkteve prej lëkure	9,9	109,1	109,1	109,1	109,1	-1,5
16	Prodhimi i drurit dhe produkteve prej druri dhe dushku, përveç mobiljeve; prodhimin e artikujve prej kashte dhe xunkthi	0,9	112,2	112,0	112,0	112,1	-0,1
17	Prodhimi i letrës dhe produkteve prej letre	1,8	104,4	104,4	104,4	104,4	0,2
19	Përpunimi i koksit dhe rafineria e nënprodukteve të naftës	2,1	102,6	102,6	102,6	102,6	0,4
20	Prodhimi i kimikateve dhe produkteve kimike	1,0	113,1	113,1	113,1	113,1	-0,2
21	Përpunimi i produkteve dhe preparateve farmaceutikë	0,2	106,7	106,7	106,7	106,7	4,4
22	Prodhimi i produkteve të kauçikut dhe plastikës	0,8	119,6	119,6	119,6	119,6	0,2
23	Prodhimi i produkteve minerale jo metalike	5,7	145,7	145,8	145,1	145,5	0,2
24	Metallurgjia	15,7	96,0	91,2	83,4	90,2	-9,0
25	Prodhimi i produkteve metalikë të fabrikuar, përveç makinerive dhe pajisjeve	5,0	114,7	114,7	114,7	114,7	0,0
26	Prodhimi i produkteve optikë, elektronikë, kompjuterikë	0,1	110,9	110,9	110,9	110,9	0,1
27	Prodhimi i pajisjeve elektrike	0,6	109,9	109,9	109,9	109,9	-0,1
28	Prodhimi i makinerive dhe pajisjeve p,k,t	0,3	118,4	118,4	118,4	118,4	1,6
29	Prodhimi i mjeteve të transportit, rimorkiove dhe gjysëmrimorkiove	0,1	102,3	102,3	102,3	102,3	0,0
31	Prodhimi i mobiljeve	1,2	104,5	104,3	105,1	104,7	1,7
32	Industri të tjera p,k,t	0,4	99,9	99,9	99,9	99,9	0,0
E	Furnizimi me ujë, aktivitete të trajtimit dhe menaxhimit të mbeturinave, mbetjeve	2,5	87,0	86,9	84,3	86,0	-1,5
38	Aktivitetet e grumbullimit, trajtimit dhe asgjësimit të mbetjeve; rikuperimi i materialeve	2,5	87,0	86,9	84,3	86,0	-1,5

Metodologjia

INSTAT llogarit dhe publikon:

- Indeksin e Çmimeve të Prodhimit Gjithsej
- Indeksin e Çmimeve të Prodhimit të Produkteve për Tregun vendas,
- Indeksin e Çmimeve të Prodhimit për Eksport

Fusha e mbulimit:

Seksioni B - Industria Nxjerrëse

Seksioni C – Industri Përpunuese

Seksioni D - Furnizimi me Energji Elektrike, Gaz e Avull dhe me Ajër të Kondicionuar

Seksioni E - Aktivitetet me ujë të ngrohtë, kanalizimeve, menaxhimit të mbeturinave dhe rregullimit

Llogaritja e indeksit

Indekset llogariten për çdo produkt të klasifikuar sipas Nomenklaturës së Produkteve (NP 2008) në nivel 6-shifror dhe publikohen sipas degëve të ekonomisë në nivel 2-shifror. Rinovimi i shportës së ndërmarrjeve dhe produkteve realizohet çdo vit duke përdorur rezultatet e Anketës Strukturore pranë Ndërmarrjeve Ekonomike jo Bujqësore. Përcaktimi i peshave të produkteve me destinacion tregun vendas mbështetet në rezultatet e po kësaj ankete, ndërsa peshat e produkteve me destinacion eksportin mbështeten në të dhënat statistikore të Tregtisë së Jashtme.

Duke filluar nga tremujori i dytë 2014 e në vazhdim Indeksi i Çmimeve të Prodhimit ka si periudhë referuese vitin 2010 = 100. Metoda e llogaritjes së indeksit është metoda zinxhir (Laspeyres - chain index) sipas së cilës, çmimi i produktit në periudhën korente (y) krahasohet me çmimin e muajit Dhjetor të vitit të mëparshëm (y – 1);

$$I_{2010}^{y,m} = \frac{100}{\frac{1}{12} \sum_{M=JAN}^{DEC} I_{2009Dec}^{2010M}} \times \prod_{Y=2010}^{y-1} I_{Y-1,dec}^{Y,dec} \times I_{y-1,dec}^{y,m}$$

- Pjesa e parë e formulës tregon ndryshimin e çmimeve të muajit Dhjetor 2010 krahasuar me mesataren e çmimeve në vitin 2010 (2010 = 100).
- Pjesa e dytë e formulës tregon lëvizjen zinxhir të indeksit të çmimeve nga muaji Dhjetor 2010 deri në periudhën y-1.
- Pjesa e tretë e formulës tregon ndryshimin e çmimeve nga muaji Dhjetor y-1 në muajin m të vitit y.

Matësit e Indeksit

Ndryshimi vjetor mat ndryshimin e çmimit midis tremujorit korent dhe të njëjtit tremujor të vitit të kaluar. Ky ndryshim është rrjedhojë e ndryshimeve vjetore në nivelet e çmimeve por mund të ndikohet edhe nga efektet e papërsëritshme të çdo tremujori.

Ndryshimi tremujor krahason nivelet e çmimit të dy tremujorëve të fundi.